



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 1251/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Arben Arifi votues i subjektit politik AAK-së në Prishtinë, paraqitur kundër komisionerëve të Vendvotimit (VV) me nr:1921E/1 në Prishtinë, për shkak të mungesës së votave për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

#### **VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Arben Arifi votues i subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në Prishtinë .

#### **Arsyetim**

Me datën 03.12.2013 në ora 16:20, Arben Arifi votues i subjektit politik AAK-së në Prishtinë ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendohet se ka votuar në shkollën Asim Vokshi në vendvotimin nr:1921E/1 ku pretendon se vota e tij dhe e katër antarve të familjes së tij nuk ju ka numëruar, pasi që kandidati për të cilin ka votuar nuk e posedon asnjë votë në këtë klasë, thuhet në pretendimet e ankuesit. Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

#### **ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore të Arben Arifi, janë të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindse pasi që ankesës në fjalë nuk i ka bashkangjitur asnjë dëshmi apo provë, për tu vërtetuar për shkeljen e supozuar andaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 1251/2013 më datën 06.12.2013.



***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.